



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KRYETARI

Nr. 1295/1 Prot.

Tiranë, më 30/03, 2022

Lënda: *Kthim përgjigje*

Drejtuar: Deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

Z. Ervin Salianji
Z. Gazmend Bardhi
Znj. Greta Bardeli
Z. Saimir Koreshi
Z. Enkeled Alibeaj

KËTU

Të nderuar deputetë,

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, me nr. 1295 prot., datë 30.03.2022, (depozituar në protokoll në orën 16:31), përmes së cilës kërkohet thirrja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me shkresën nr.1274 prot., datë 29.03.2022, për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Alqi Bllako, së bashku me relacionin përkatës të arsyetuar ju sqarojmë se:

Nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka ardhur kërkesa me nr. 2407 Prot., datë 29.03.2022, protokolluar në Kuvend me nr.1274 Prot, datë 29.03.2022 për dhënie autorizimi për arrestimin e shtetasit Alqi Bllako, deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të Rregullores, pas depozitimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, menjëherë me Urdhrin nr. 22, datë 29.03.2022 të Kryetares së Kuvendit është urdhëruar thirrja e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të shqyrtuar këtë kërkesë.

Neni 13, pika 5 e Rregullores së Kuvendit, përcakton se Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ka në kompetencë shqyrtimin e kërkesave për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin e një deputeti dhe neni 118 i Rregullores parashikon procedurën e shqyrtimit të kërkesave të tilla.

Me shkresën nr. 1274/5, datë 30.03.2022, z. Alqi Bllako, për të cilin është kërkuar dhënia e autorizimit për arrestim nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka paraqitur në Kuvend deklaratën se me dijeni dhe vullnet të plotë dorëzon mandatin e deputetit nëpërmjet heqjes dorë nga ky mandat. Referuar nenit 71, pika 2 shkronja “b” te Kushtetutës, mandati i deputetit Z. Alqi Bllako, mbaron për arsye të heqjes dorë nga mandati.

Në këto kushte, sipas Rregullores së Kuvendit, kërkesa e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është më objekt i shqyrtimit nga Kuvendi.

Sa më sipër, me Urdhrin e arsyetuar nr. 24, datë 30.03.2022, është anuluar mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, njoftuar për datën 30.03.2022, ora 18:00.

Kërkesa Juaj, datë 30.03.2022 për thirrjen e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin në orën 18:00, depozituar pasditen e së njëjtës ditë, bëhet për të njëjtën çështje rendi dite si edhe mbledhja e anuluar me Urdhërin nr.24, datë 30.03.2022, të Kryetares së Kuvendit.

Siç parashtohet qartë më sipër, çështja për të cilën Ju kërkonti mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin nuk ekziston më. Për rrjedhojë, Kuvendi nuk mund të vazhdojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

KRYETARE
LINDITA NIKOLLA

